# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7196
E hënë, 26 maj 2024
Çmimi 0. 50


## KFOR-i mohon se ndërmjetësoi për largimin e paramilitarëve serbë nga Banjska

FAQE 5





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


MBLEDHJA E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË NATO-S FAQE 4

# BËHET THIRRJE QË ALEATËT TË KONSULTOHEN PËR TA AVANCUAR STATUSIN E KOSOVËS NË NATO




Lordi Lancaster, në kuadër të ruajtjes së paqes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor, gjatë Asamblesë Parlamentare të aleancës në Sofje, teksa paraqiti draft-raportin ku përmendet Kosova, kërkoi konsensus të aleatëve të NATO-s për zgjerim, duke thënë se ata duhet të konsultohen për ta avancuar statusin e Kosovës në këtë organizatë. Ai vuri theksin kryesor në sfidat dhe kërcënimet nga tensionet të cilat janë krijuar në Kosovë dhe BeH që nga viti 2023, ku pati një rikthim të konsiderueshëm të konfrontimeve të dhunshme në veri të Kosovës, që kulmuan me sulmin terrorist ne Banjskë, ku u vra një pjesëtar i Policisë së Kosovës

## KURTI: TË DHËNAT NGA REGJISTRIMI I POPULLSISË, BAZË PËR VENDIME MË TË MIRA F. 3





## GËRVALLA NË UASHINGTON DISKUTON PËR SIGURINË NË BALLKANIN PERËNDIMOR F. 3

## AKTUALE



### ZELENSKI, PESË VJET NGA MARRJA E DETYRËS SË PRESIDENTIT TË UKRAINËS F. 2

### DEBATI PËR ZGJEDHJET EVENTUALE MBULON DËSHTIMET QEVERITARE, NË VEÇANTI DËSHTIMIN NË KËSHILLIN E EVROPËS F. 6

Shkruan: Safet GËRXHALIU

### ANËTARI I KRYESISË SË LDK-së: KOSOVA NË SANKSIONE NDËRKOMBËTARE TASH E NJË VIT F. 3

## EKONOMI



### KOSTOJA E KULTIVIMIT: BUJQIT E KOSOVËS NDIEJNË PESHËN E TAKSËS F. 7

### BIZNESET E QUAJNË TË DOMOSDOSHËM DIGJITALIZIMIN E KOMPANIVE DHE ADMINISTRATËS SHTETËRORE F. 7

## SPORT




### KHF ISTOGU, KAMPION I KOSOVËS NË HENDBOLL F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri +38344685122
Internet Website, Marketing...

# Macroni nis vizitën zyrtare në Gjermani



BERLIN, 26 MAJ - Emmanuel Macroni arriti në Berlin më 26 maj, në vizitën e parë në Gjermani që një president francez ka realizuar që 24 vjet. Gjatë vizitës, lideri francez synoi t'i ulë tensionet dhe të paralajmërojë për rreziqet që vijnë nga ekstremi i djathtë para mbajtjes së zgjedhjeve të Bashkimit Evropian.
Macroni do të qëndrojë në Gjermani për tri ditë dhe gjatë kësaj vizite pritet ta theksojë rëndësinë historike të raporteve të pasluftës mes dy shteteve kyçe në BE, teksa Franca muajin e ardhshëm shënon 80-vjetorin e dhënies fund të pushtimit gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, raportet mes Parisit dhe Berlinit janë përkeqësuar për shkak të refuzimit të idesë së Macronit nga Gjermania që të dërgohen trupa në Ukrainë.
Përderisa Macroni shpesh viziton Berlinin, kjo është vizita e parë zyrtare e një presidenti francez që 24 vjet, pas vizitës që zhvilloi Jacques Chiran më 2000. Të dielën Macroni është takuar me homologun gjerman Frank-Walter Steinmeier.
Ndërkaq, të hënën ai do të qëndrojë në Dressden, ku do të mbajë një fjalim në Festivalin Evropian. Të martën Macroni do të qëndrojë në Muster dhe më pas në Meseberg, ku do të zhvillojë bisedime me kancelarin gjerman Olaf Scholz dhe do të mbahet një takim i përbashkët i qeverive të të dyja shteteve.

# Zelenski, pesë vjet nga marrja e detyrës së presidentit të Ukrainës

KIEV, 26 MAJ - Më 20 maj u bënë pesë vjet që kur presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenski mori detyrën. Sipas ligjit të Ukrainës, presidenti ka një mandat pesëvjeçar, por zgjedhjet janë shtyrë, ndërsa në vend vazhdon të jetë në fuqi ligji i mobilizimit ushtarak.
Presidenti Zelenski ka pasur një mandat sfidues, duke udhëhequr vendin në periudhën e vështirë të sulmit në shkallë të gjerë të Rusisë, që ende po vazhdon.
Pesë vjet më parë, një politikan i ri, por një fytyrë e njohur për ukrainasit, u bë president i vendit. Aktori, komediani dhe sipërmarrësi 41-vjeçar Volodymyr Zelenski mori detyrën si presidenti i gjashtë i Ukrainës. "Ukraina është një vend me paradokse të shumta politike. Dhe presidenca e Zelenskit është një nga paradokset më të jashtëzakonshme. Politika ishte për të një temë që ai e trajtonte me sarkazëm dhe shaka. Por, ai papritmas e gjeti veten në vendin e atyre që i kritikonte dhe tallte", thotë Volodymyr Fesenko nga Qendra për Studime Politike "Penta". "Në Amerikë njerëzit ishin të habitur që ky aktor arriti të fitonte 73 % të votave. Ishte thjesht e mahnitshme! Por ai nuk kishte shumë përvojë, dhe mendoj se në ditët e para ai pati nevojë për pak kohë që të krijonte një ekip këshilltarësh dhe ta fitonte përvojën që i nevojitej", thotë JohnTefft, ish-ambasador i Shteteve të Bashkuara në Ukrainë.
Ndër premtimet e Zelenskit ishin lufta ndaj korrupsionit dhe varfërisë si dhe përpjekja për ta bindur presidentin rus Vladimir Putin për t'i kthyer Ukrainës Krimenë dhe Donbasin. "Nëse takohem me zotin Putin, do t'i them: 'Më në fund, na kthyet territoret tona. Sa para jeni të gatshëm të paguani si kompensim për mbajtjen e tyre?'". "Ai mendonte se do të fillonte negociatat me Putinin dhe do ta bindte se dëshiron



paqe dhe se Putini gjithashtu donte paqe. Ai u përpoq ta bënte këtë, por kjo nuk funksionoi. Rezultoi se Zelenski donte paqe, por jo Putini. Ai donte që Ukraina të nënshtrohej", thotë analisti Volodymyr Fesenko.
Më 24 shkurt 2022, Rusia nisi një sulm në shkallë të gjerë ndaj Ukrainës. Shumë ekspertë perëndimorë mendonin se presidenti Zelenski do të largohej nga vendi, por ai qëndroi në Ukrainë, duke e udhëhequr atë gjatë luftës. "Zelenski u bë një udhëheqës i kohës së luftës. Ai ndryshoi fizikisht dhe psikologjikisht. Ai pothuajse ndaloi së qeshuri. Ai duket më i pjekur dhe më i ashpër", thotë Fesenko.
Në vitin 2022, revistat "Time" dhe "Financial Times" e shpallën Zelenskin "Njeriun e Vitit". Ai ka bërë udhëtime të shumta në vijën e parë të frontit, duke përfshirë ato në Bakhmut dhe Avdiivka, si dhe qytetet e çliruara të Buçës, Izumit dhe Khersonit. Ai ka mbajtur dy fjalime në Kongresin amerikan dhe është takuar shumë herë me presidentin Joe Biden. "Në përgjithësi, ai ka treguar aftësi të forta udhëheqëse. Pa të nuk e di se ku mund të ishte Ukraina sot", thotë analisti John Hardie nga Fondacioni për Mbrojtjen e Demokracive.
Presidenti Zelenski thotë se do të mbetet president për aq kohë sa në Ukrainë do të jetë në fuqi ligji i mobilizimit ushtarak.

# Borrell: Një Autoritet i fortë Palestinez, i nevojshëm për paqe në Lindjen e Mesme

BRUKSEL, 26 MAJ - Një Autoritet Palestinez "i fortë" është i nevojshëm për të sjellë paqe në Lindjen e Mesme. Kështu tha shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, teksa u takua me kryeministrin palestinez Mohammed Mustafa më 26 maj. "Është edhe në interesin e Izraelit që Autoriteti Palestinez të jetë funksional sepse në mënyrë që të arrihet paqja, na duhet një Autoritet i fortë Palestinez, e jo i dobët", tha Borrell.
Ai i bëri këto deklarata para nisjes së takimit me kryeministrin palestinez, me të cilin tha se do të diskutojë se si Autoriteti Palestinez mund të forcohet që ta marrë udhëheqjen e Gazës nga Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. "Ne e shohim takimin e sotëm si një mundësi shumë të rëndësishme për ne si qeveri, si ekzekutiv i ri për të prezantuar para partnerëve tanë ndërkombëtarë prioritetet tona dhe planet për të ardhmen", tha Mustafa.
Kryeministri palestinez tha se prioritet i tij i parë është t'i mbështesë palestinezët në Gazë, veçmas përmes një armëpushimi dhe më pas "rindërtimi i institucioneve të Autoritetit Palestinez" në Gazë.
Hamasi mori kontrollin e Gazës nga Autoriteti Palestinez më 2007.
Mustafa, po ashtu, u bëri thirrje partnerëve ndërkombëtarë t'i bëjnë presion Izraelit t'i zhbllokojë fondet për Autoritetin Palestinez "që ne të jemi gati për t'i reformuar institucionet tona... dhe shpresojmë që së bashku të bëjmë përpjekje drejt shtetësisë dhe paqes në rajon".
Takimi në Bruksel pritet të përqendrohet edhe në ndihmën ndërkombëtare për palestinezët, teksa lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit në Gazë po vazhdon për më shumë se shtatë muaj.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Gërvalla në Uashington diskuton për sigurinë në Ballkanin Perëndimor

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Uashington, 26 maj - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, mori pjesë në një tryezë diskutimi në Institutin "Hudson" në Uashington, ku u përqendrua në sfidat e sigurisë dhe potencialin e zhvillimit në Ballkanin Perëndimor. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga politika, diplomacia dhe analistë të njohur ndërkombëtarë.

Në takimin e titulluar "Synime dhe shqetësime rajonale", ministrja Gërvalla foli për sfidat me të cilat përballen sot Kosova, rajoni i Ballkanit dhe Evropa Lindore. Duke përshkruar zhvillimin e jashtëzakonshëm të Kosovës, të ekonomisë së saj, por edhe të forcimit të të gjitha strukturave të sigurisë dhe forcave të saj të armatosura, ajo theksoi përkushtimin e vazhdueshëm të Kosovës për vlerat demokratike dhe vullnetin e palëkundur për anëtarësim në NATO dhe BE.

Diskutimi në Institutin "Hudson" theksoi edhe rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për t'i adresuar sfidat e përbashkëta dhe për ta përshpejtuar përparimin drejt anëtarësimit në NATO dhe BE.

Duke iu përgjigjur shqetësimeve të shumta të të pranishmëve, ajo theksoi se Serbia është kthyer përsëri në një kërcënim të vërtetë jo vetëm për Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën, por për të gjithë rajonin. "Si aleate, madje edhe satelit i Rusisë, ajo jo vetëm që sulmon shtetet fqinje, siç ishte rasti më 24 shtatorin e vitit të



kaluar në Kosovë, por edhe i garanton Rusisë, Kinës dhe tashmë edhe Iranit, hapësirë të mjaftueshme për të vepruar në Evropë nga thellësia e Ballkanit Perëndimor", tha ministrja Gërvalla.

Ministrja Gërvalla theksoi rëndësinë e ndërrimit të strategjisë së demokracive perëndimore në raport me Serbinë si kundërshtaren më të fuqishme të vlerave Perëndimore dhe demokratike në Evropë dhe domosdoshmërinë e konfrontimit të Serbisë me rrezikun që paraqet për rajonin dhe për paqen në Evropë.

# Anëtari i Kryesisë së LDK-së: Kosova në sanksione ndërkombëtare tash e një vit

Prishtinë, 26 maj - Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Muhamet Hamiti, ka kujtuar se para një viti sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, i kishte dënuar veprimet e pakoordinuara të Qeverisë së Kosovës në veri.

Duke cituar fjalët e Blinkenit për paralajmërimin për "pasoja në marrëdhëniet bilaterale", ai ka kujtuar se si kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i kishte quajtur ato



"naive" e se si kryediplomatja Donika Gërvalla e kishte quajtur BE-në "tigër prej letre". "Dy javë më vonë, më 14 qershor 2023, të 27 vendet anëtare të BE-së vendosën unanimisht masa ndëshkuese ndaj Kosovës që përfshinin, sipas zëdhënësit të BE-së, Peter Stano, 'pezullim të vizitave të nivelit të lartë… si dhe të bashkëpunimit tonë financiar me Kosovën'. Janë bllokuar projekte/programe të BE-së për Kosovën në vlerë prej qindra milionë eurosh deri tani. Republika e Kosovës është në nivelet më të ulëta në raportet me ShBA-në gjatë këtij viti. Po ashtu, tash e gati një vit me sanksione ndërkombëtare të miqve dhe aleatëve të vet. Këtë arritje qeveria e Vetëvendosjes nuk e shënon. Pasojat e tyre i vuajnë qytetarët e Kosovës, pa dallim, si ata që e kanë votuar qeverinë e shpresës që po del të jetë qeveri e zhgënjimit, ashtu edhe ata që nuk e kanë votuar", ka shkruar Hamiti në "Facebook".

# Kurti: Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë, bazë për vendime më të mira

Prishtinë, 26 maj - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se rezultatet e regjistrimit të popullsisë do t'u mundësojnë institucioneve që të krijojnë politika, strategji dhe të marrin vendime më të mira për zhvillim më të qëndrueshëm.

Këto deklarata Kurti i bëri gjatë ceremonisë së mbajtur për shënimin e përfundimit të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë. "Të dhënat e mbledhura do të jenë baza për politika, strategji e vendime më të mira, për një zhvillim edhe më të hovshëm e më të qëndrueshëm të vendit tonë", tha Kurti.

Regjistrimi i popullsisë nisi më 5 prill. Fillimisht ishte caktuar që të përfundonte më 17 maj, por pas kërkesave të disa komunave, procesi u shty deri më 24 maj.

Gjatë këtij procesi edhe diaspora ka mundur të regjistrohet përmes një platforme online.

Agjencia e Statistikave të Kosovës e vlerësoi të suksesshëm procesin e regjistrimit.

"Regjistrimi i popullsisë, si një nga projektet më madhore dhe më komplekse të një vendi në kohë paqeje, përkundër sfidave dhe kompleksitetit që ka pasur, u realizua me shumë sukses. Suksesi është arritur falë bashkëpunimit dhe koordinimit që ka pasur ASK-ja me institucionet e tjera [vendore e ndërkombëtare]", u tha në njoftimin për medie të ASK-së.

Më 5 prill, kur kishte filluar regjistrimi, Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit, kishte thënë se serbët nuk do të merrnin pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë në vitin 2011 nuk ishte mbajtur në katër komunat në veri, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan të banuara me shumicë serbe, ndërsa serbët nga komunat e tjera në jug, me ftesë të Beogradit, kryesisht e kishin bojkotuar procesin.

Sipas Ligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, çdo person mund të gjobitet nga



30 deri në 2 000 euro nëse refuzon t'i japë informacionet e kërkuara nga regjistruesi.

Gjobat janë edhe më të mëdha, deri në 20 000 euro, për biznese.



MBLEDHJA E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË NATO-S

# Bëhet thirrje që aleatët të konsultohen për ta avancuar statusin e Kosovës në NATO

Lordi Lancaster, në kuadër të ruajtjes së paqes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor, gjatë Asamblesë Parlamentare të aleancës në Sofje, teksa paraqiti draft-raportin ku përmendet Kosova, kërkoi konsensus të aleatëve të NATO-s për zgjerim, duke thënë se ata duhet të konsultohen për ta avancuar statusin e Kosovës në këtë organizatë. Ai vuri theksin kryesor në sfidat dhe kërcënimet nga tensionet të cilat janë krijuar në Kosovë dhe BeH që nga viti 2023, ku pati një rikthim të konsiderueshëm të konfrontimeve të dhunshme në veri të Kosovës, që kulmuan me sulmin terrorist ne Banjskë, ku u vra një pjesëtar i Policisë së Kosovës

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 MAJ - Lordi Mark Lancaster ka kërkuar konsensus të aleatëve të NATO-s për zgjerim, duke thënë se ata duhet të konsultohen për ta avancuar statusin e Kosovës në këtë organizatë. "Aleatët duhet të përdorin korniza konsultative për ta avancuar çështjen lidhur me statusin e Kosovës. Ata që nuk e njohin statusin e Kosovës mund ta mendojnë pjesëmarrjen e Kosovës në NATO dhe në Partneritetin për Paqe", tha ai gjatë Asamblesë Parlamentare të aleancës teksa prezantoi draft-raportin ku përmendet Kosova.

Gjatë Asamblesë, që po mbahet në Sofje, Kuvendi i Kosovës synon ta avancojë statusin e tij nga vëzhgues në anëtar të asocuar të kësaj organizate.

Autoritetet e Kosovës bën me dije në mars se Komisioni i Përhershëm i Asamblesë Parlamentare të NATO-s e ka avancuar statusin e Kuvendit të Kosovës në këtë trup.

Duke paraqitur draft-raportin, Lancaster përmendi edhe dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai tha se aleatët e NATO-s, por edhe Bashkimi Evropian si ndërmjetësues, duhet të vazhdojnë t'i bëjnë presion Kosovës dhe Serbisë që ta zhbllokojnë procesin e dialogut dhe ta arrijnë normalizimin e raporteve.

Ai foli edhe për ndikimin e Kinës dhe Rusisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst, ai përmendi rritjen e shitjes së armëve ruse dhe kineze në Serbi dhe në entitetit e Republikës Sërpska të Bosnjë-Hercegovinës. "Ndikimi i Rusisë në Ballkanin Perëndimor është ta destabilizojë këtë pjesë të botës dhe t'i pengojë integrimet transatlantike, po ashtu për të ndërtuar varësi energjetike në sektor, duke testuar liderë të caktuar. Rusia ka mbështetur agjendën e ndarjes, duke i ofruar armatim Republikës Serbe dhe Serbisë", tha Lancaster.

Asambleja Parlamentare e NATO-s, ku Kosova synon ta avancojë statusin e saj, është institucionalisht e ndarë nga NATO-ja, por shërben si një lidhje e rëndësishme mes NATO-s dhe parlamenteve të vendeve anëtare.

Ajo përbëhet nga 281 delegatë nga të 32 vendet anëtare të NATO-s.

Përveç tyre, në aktivitete e saj marrin pjesë edhe delegatë nga 9 vende të asocuara, 4 vende të asocuara mesdhetare, si dhe 8 delegacione vëzhguese parlamentare.

Anëtarët e asocuar mund të paraqesin rezoluta dhe ndryshime në rezoluta. Gjithashtu, mund të shërbejnë si raportues specialë të asocuar në komitete, për t'i paraqitur perspektivat e tyre në raportet NATO-Asamble Parlamentare.

Megjithatë, ata nuk kanë të drejtë të votojnë për raportet, rezolutat apo udhëheqjen e Asamblesë dhe as nuk kontribuojnë në buxhetin e saj.

Aktualisht anëtare të asocuara janë nëntë - në mesin e tyre edhe Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina.

Kuvendi i Kosovës prej vitesh



# Tahiri: Regjistrimi i popullsisë prodhon efekte të dyanshme

PRISHTINË, 26 MAJ - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se regjistrimi i popullsisë i realizuar këtë vit prodhon efekte të dyanshme. Përmes një reagimi në “Facebook”, Tahiri ka thënë se sa më parë duhet të sillet në Kuvend Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal. “Regjistrimi i Popullsisë 2024 prodhon efekte të dyanshme. Negative: Financimi komunal, përcaktohet sipas formulës ku kriteri kryesor i ndarjes buxhetore është numri i banorëve. 89% e grantit për komuna ndahet në bazë të kriterit ‘Për Kapita’. Kjo situatë do të reflekton edhe në numrin e anëtarëve të kuvendeve komunale dhe pagat e të emëruarve dhe zgjedhurve politik. Si përgjigje ndaj kësaj, duhet reflektuar edhe formulat e financimit, ngase komunat përtej numrit të banorëve kanë përgjegjësinë e investimeve kapitale, e kjo me shtrirje të gjerë në territor, mirëmbajtjen e objekteve shkollore, spitalore e publike, si dhe pagesat e komunalive e bënë edhe më të vështirë. Për këtë duhet të sillet sa më shpejt në Kuvendin e Kosovës, projektligji për Financat e Pushtetit Lokal, si instrument për financim të qëndrueshëm e garantim të mirëqenies dhe zhvillimit në komuna”, ka thënë Tahiri, duke shtuar se duhet qartësi në këtë proces. “Është e vërtetë që numrat pas regjistrimit do të pasqyrojnë më qartë planifikimin e politikave. Mirëpo, kjo domosdo duhet të ndiqet edhe me programe për përkrahjen e familjes, si domosdoshmëri që të mos përmbyset piramida e moshës. Pas regjistrimit të popullsisë është e domosdoshme që shteti të rimendoi politikat si refleksion e statistikave, por edhe thelluar në trajtimin analitik dhe veprim qeverisë, përndryshe sistemi i financimit komunal do të kapitullon”, ka theksuar Tahiri.




# KFOR-i mohon se ndërmjetësoi për largimin e paramilitarëve serbë nga Banjska

PRISHTINË, 26 MAJ - Grupi Ndërkombëtar i Krizave së fundmi publikoi një raport në lidhje me veriun e Kosovës dhe atë që kishte ndodhur në Banjskë në shtator të vitit të kaluar.

Në rrëfimin e tij për dhunën që ndodhi në Banjska në shtator 2023, raporti i Grupit të Krizave thekson se: “Duke pasur frikë nga një gjakderdhje, KFOR-i negocioi tërheqjen e grupit [terroristëve të armatosur serbë] në pyjet përreth, nga të cilat pyje ata u ‘zhdukën’”.

KFOR-i në një reagim publik tha se ky raportim është i pasaktë. “Në asnjë moment KFOR-i nuk ishte i përfshirë në negociatat e supozuara”, vijon komunikata.

Pasi u thirr për ta përforcuar praninë e tij, KFOR-i thotë se u koordinua ngushtë me Policinë e Kosovës dhe misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX) për ta rivendosur sigurinë në zonë. “Dhuna që ndodhi në Banjska erdhi pas një sulmi kundër paqeruajtësve të KFOR-it në maj të vitit 2023, i cili rezultoi me plagosjen e 93 pjesëtarëve të KFOR-it, disa prej të cilëve pësuan lëndime të rënda”.




KFOR-i thotë se NATO ka mbajtur gjithmonë qëndrimin se faktet duhet të vërtetohen dhe autorët duhet të përballen me drejtësinë. “Pas dhunës, NATO ka dislokuar rreth 1 000 paqeruajtës shtesë dhe forca të blinduara me armë të rënda në Kosovë. Ky ka qenë përforcimi më i madh i kontingjentit tonë në Kosovë në një dekadë, dhe kjo tregon se NATO është e gatshme ta ruajë paqen”, vijon komunikata.

KFOR-i thotë se vazhdon ta zbatojë mandatin e tij për të siguruar një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme.

---

është delegacion vëzhgues me dy ulëse. Me ngritjen e nivelit të përfaqësimit do të zgjerohej edhe delegacioni pjesëmarrës kosovar.

Që kur ka nisur pushtimi rus i Ukrainës në shkurt të vitit 2022, autoritetet e Kosovës kanë kërkuar anëtarësim të përshpejtuar në NATO.

Shteti kërkon që fillimisht të bëhet pjesë e Partneritetit për Paqe dhe më pas të anëtarësohet plotësisht në aleancë.

Forcat e NATO-s janë të pranishme në Kosovë qysh në qershor të vitit 1999, pas përfundimit të luftës dhe tërheqjes së forcave serbe.

Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës në AP të NATO-s, i përbërë nga deputetët Driton Hyseni, kryesues dhe Xhavit Haliti, anëtar, po merr pjesë në punimet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s që po mbahet në Sofje.

Pas raportit pati diskutime nga delegacionet pjesëmarrëse, ku u vlerësua cilësia e raportit si dhe u theksua rëndësia e madhe që ka për NATO-n ruajtja e sigurisë dhe paqes në Ballkanin Perëndimor, edhe për faktin se NATO-ja është në Kosovë përmes KFOR-it.

U propozuan edhe disa mekanizma që BE-ja do të mund t’i imlementojë në mënyrë që të sigurohet paqja në këtë pjesë të rajonit.

Gjithashtu, ndikimi i Rusisë dhe Kinës u cilësua i rrezikshëm dhe që ka për qëllim destabilizimin e rajonit.

Delegacioni i Serbisë ndërkaq u ‘ankua’ për, siç u tha, të drejtat e limituara të serbëve në Kosovë si dhe që Kosova nuk e ka përmbushur detyrën e saj sipas marrëveshjes për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Anëtarët e delegacionit serb u shprehën se FSK-ja është ilegale dhe se e vetmja forcë e pranuar për serbët është KFOR-i dhe përforcimi i shtuar ndërkombëtar për ta siguruar komunitetin serb.

Në këtë debat deputeti Driton Hyseni falënderoi Lancaster për raportin cilësor si dhe i falënderoi të gjitha vendet aleate të NATO-s, përfshirë edhe Lancaster dhe çdo ushtar për kontributin e tyre për ta çliruar Kosovën në vitin 1999.

Në kundërshtim të delegacionit serb ai theksoi se “jemi duke u përballur me situata kur përfaqësuesit politikë të Serbisë po bëjnë deklarata pa kuptim, pa iu referuar realitetit dhe me potencial shumë të lartë të qasjes destruktive ndaj paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor”.

“Ju nuk mund t'i referoheni as provincës jugore të një vendi tjetër, një vendi të pavarur, të njohur nga 117 vende, duke përfshirë shumicën e anëtarëve të NATO-s. Po ashtu, deklarata se aktivitetet e forcave të sigurisë në Kosovë janë të paligjshme, më lejoni të sqaroj se të gjitha kapacitetet e forcave tona të sigurisë, Ushtrisë së Kosovës, policisë dhe institucioneve të tjera janë projektuar dhe zhvilluar në bashkëpunim të plotë me institucionet e Kosovës, me NATO-n, me aleatët”, theksoi deputeti Hyseni.

Ai komentoi ndikimin rus në rajon, të përmendur në raport, si dhe paralajmëroi se do t’i dërgojnë me shkrim komentet për raportin, nëse shihet e nevojshme.

Një nga propozimet e dala gjatë këtij diskutimi ishte edhe ai që bëri deputeti Driton Hyseni dhe i cili u përkrah plotësisht nga Lancaster, i cili kërkoi që BE-ja të gjejë mënyra për ta detyruar Beogradin ta nënshkruajë marrëveshjen dhe kësisoj detyrohet për implementimin e tyre.

# Debati për zgjedhjet eventuale mbulon dështimet qeveritare, në veçanti dështimin në Këshillin e Evropës



Shkruan:
Safet GËRXHALIU

Fuqia e një shteti varet shumë nga partneriteti strategjik që ka me aleatët ndërkombëtarë e në veçanti me shtetet mike evropiane dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtë partneritet Qeveria e Kosovës e ka luhatur dhe dëmtuar në masë të madhe sa që e rrezikon mbështetjen e nevojshme që do të ketë Kosova në të ardhmen. Në rrugën e saj integruese në shumë institucione ndërkombëtare e në veçanti në KiE, BE dhe NATO, Kosova e ka të pamundur progresin apo edhe anëtarësimin pa ndihmën dhe lobimin e partnerëve dhe miqve ndërkombëtarë, në veçanti pa mbështetjen e ShBA-ve që janë më meritorët për lirinë e Kosovës por edhe pavarësinë e saj dhe për ndërkombëtarizimin e Republikës së Kosovës në mbarë botën.

Është momenti kur politikanët e Kosovës duhet të kuptojnë të vërtetën se edhe kur ne mendojmë se ShBA-të janë gabim ata kanë të drejtë.

George Friedman në librin "100 vitet e ardhshme" me shumë analiza dhe parametra ekonomik, politik, gjeostrategjik, inovativ dhe zhvillimor e argumenton faktin se shekulli i 21 është shekulli i fillimit të dominimit të ShBA-ve dhe a e dinë këtë apo a e kanë lexuar politikanët e Kosovës që sillen në këtë mënyrë?!

Dështimet qeveritare janë të shumta, në veçanti në rrafshin ekonomik, politik,social kulturor, integrues, edukativ, shëndetësor, në aspektin diplomatik dhe në veçanti në ruajtjen e imazhit të saj në arenën ndërkombëtare.

Rasti i Banjskës që ndodhi në shtatorin e vitit të kaluar që ishte një kthesë tragjike por edhe në favor të Kosovës ku u krijua një momentum i ri për Kosovën por nuk u shfrytëzua sa e si duhet.

Hapja e "kutisë së Pandorës" me çështjen e dinarit serb është një autogol që e dëmtoi dhe e goditi Kosovën ndoshta sikur trazirat e marsit 2004.

Të jemi shkaku i faktorizimit të Serbisë në Këshillin e Sigurimit, të qortohet Kosova edhe nga miqtë evropianë dhe amerikanë për këtë veprim është dhurata më e mirë për Serbinë dhe Rusinë e dhuruar nga vetë institucionet kosovare.

Çështja e dinarit u politizua deri në atë masë sa që tani është temë e dialogut në Bruksel.

Tani dinari për serbët në veri nuk është vetëm mjet paqësor por është emocion dhe "mollë e ndaluar", dhe prapë partneriteti me miqtë ndërkombëtar u anashkalua.

Pas liberalizimit të lëvizjes pa viza në BE si proces të shumë pritur nga qytetarët e Kosovës, anëtarësimi në Këshillin e Evropës dukej se do të rritë shpresat për përshpejtimin e integrimit në BE dhe me kohë në NATO por edhe në këtë proces dështuam si pasojë e mos dëgjimit dhe moskoordinimit me miqtë ndërkombëtar.

Duke pasur parasysh faktin se opozita aktuale është inerte dhe e pa vizion ra pre e "darkës së gabuar" por shumë mirë të gatuar nga kryeministri Kurti.

Në vend që opozita të merret me dështimet qeveritare në çdo pore të shoqërisë, ajo ra në grepin e zgjedhjeve që janë në duart e kryeministrit e jo të Qeverisë.

Zgjedhjet eventuale mund të jenë të shpallura atëherë kur ai mendon se është momenti e jo kur opozita kërkon.

Fati i Kurtit është që në opozitë nuk e ka Albinin si opozitar profesional!

Opozita, analistët dhe gazetarët nëpër studio televizive sot debatojnë për zgjedhje eventuale pa datë e me konspiracion në vend që të debatojnë për dështimet e shumta të cilat e kanë shndërruar Kosovën në shtet nga i cili duhet ikur e jo në shtet me vizion dhe për të jetuar e qëndruar në të.

Ikën qytetarët dhe kapitali i bizneseve vendore nga Kosova e qeveria në heshtje i realizon objektivat e veta për pushtet e në interes të partisë politike e jo për shtet e në interes të qytetarëve të Republikës sonë.

Masat ndëshkuese nga Bashkimi Evropian po vazhdojnë të jeni fuqi e si duket edhe të qëndrojnë edhe gjatë në qoftë se nuk rritet përgjegjësia dhe llogaridhënia për dështimet në kontinuitet.

Zgjedhjet nuk janë fontanë dëshirash por vizion dhe mision për zhvilluar shtetin e për të mbështetur qytetarin e jo për të kapur pushtetin.

# Kurti përkujton 27 martirët e Tusuzit

**Prizren, 26 maj** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë homazhe të dielën në qytetin e Prizrenit. Ai ka vënë kurora me lule te varret e të vrarëve në masakrën e Tusuzit, në nderim dhe përkujtim të martirëve e dëshmorëve të Lagjes së Trimave. "Martirët dhe dëshmorët e kombit janë në njërën anë dëshmi e qëndresës sonë, e rezistencës së popullit, e atdhedashurisë për të jetuar në liri e në paqe në tokën stërgjyshore, por në anën tjetër janë gjithashtu edhe dëshmi e krimeve të Serbisë, e krimeve të kryera gjatë luftës, ku bëjnë pjesë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidi", tha kryeministri Kurti.

Kurti përkujtoi martirët e lagjes së Trimave-Tusuzit, që para 25 vitesh u vranë mizorisht dhe në mënyrë të pamëshirshme. "27 martirët e Tusuzit janë sot 27 lule nga të cilët rritet liria jonë dhe gëzohet shteti ynë", tha ai.

Në këto homazhe, teksa përkujtoi të rënët e masakrës, kryeministri u shpreh se në lapidarin e të rënëve është i skalitur emri i Behar Abdylmexhitit, i cili atë kohë ishte vetëm 17-vjeçar, si dhe Fazile Maqkaj, e cila u dogj e gjallë në karrocën invalidore të saj.

Më tej, kryeministri, duke përmendur djegien e mbi 300 shtëpive dhe dhembjen për vrasjen e 27 civilëve nga forcat armike serbe, që sot janë martirë të kombit, theksoi se nevojitet edhe drejtësia e jo vetëm pavarësia e shtetit.

Teksa foli për këtë masakër, për të cilën vetëm dy persona mbahen në burg dhe katër të tjerë ndiqen, ai shtoi se numri i ekzekutorëve dhe urdhërdhënësve është shumë më i madh se kaq. Prandaj, me këtë rast ai i bëri thirrje prokurorisë së shtetit që me fuqinë dhe dijeninë e saj të bëjë gjithçka në mënyrë që të ketë drejtësi për më të dashurit tanë që mungojnë tash e 25 vjet. "Sepse drejtësia i mbyllë plagët që kullojnë dhe sjellë paqe të qëndrueshme", përfundoi kryeministri.



# Kostoja e kultivimit: Bujqit e Kosovës ndiejnë peshën e taksës



PRISHTINË, 26 MAJ - "Është e papërballueshme. Na duhen lehtësira e jo ngarkesa të tilla financiare", thotë bujku Valon Vehapi. Prej vitesh ai kultivon mbi 150 hektarë tokë me prodhime të ndryshme bujqësore në komunën e Lipjanit - pjesa qendrore e Kosovës.
Por, nisur nga ky vit, ka edhe kosto shtesë: pagesën e tatimit për tokën bujqësore.
Kjo taksë ka nisur të aplikohet në bazë të Ligjit për Tatim në Pronën e Paluajtshme, i cili është ndryshuar dhe plotësuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht të vitit 2023.
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës siguron se disa bujq do të kenë lehtësime, por nga organizatat që i mbështesin bujqit, thonë se taksa do t'i dëmtojë dhe do t'i demotivojë ata për të punuar tokat.
E pyetur nga REL-i se si është duke shkuar procesi i pagesës - afati për të cilën përfundon më 30 shtator - kjo ministri nuk u përgjigj.
Me ligj, ata që nuk e paguajnë tatimin, ndëshkohen me gjobë prej 10% të vlerës së tatimit të papaguar.
Tatimi për tokat bujqësore përcaktohet nga shumëzimi i vlerës së pronës - përkatësisht çmimi për metër katror - me normën tatimore.
Në përgjigjen e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhënë Radios Evropa e Lirë, thuhet se "norma tatimore për vitin 2024 ndryshon nëpër komuna nga 0.10 % deri në 0.15 % - varësisht zonës, kategorisë së tokës dhe vlerës së tregut".
Vehapi mbi 140 hektarë të tokave që i shfrytëzon, i ka me qira dhe për ta paguan nga 80 deri në 300 euro për hektar, varësisht vlerës së pronës.
Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai tregon se pronarët e tokave ia kanë dorëzuar atij faturat e tatimit."Nga një faturë i kam paguar 70 euro për një hektar. Faturat e tjera kanë qenë me vlera më të ulëta", thotë Vehapi.
Bashkim Zejnullahu, udhëheqës i Shoqatës së Mullisëve të Kosovës, thotë se hapësira e tokës së punueshme në Kosovë edhe ashtu është e pamjaftueshme - taksa, sipas tij, do t'i shtyjë buqit të heqin dorë nga punimi i tokës.
Nga kulmi i inflacionit në vitin 2022 e këndej, bujqit janë përballur me sfida të vazhdueshme, që kanë nisur me shtrenjtimin e naftës dhe të produkteve të tjera për prodhim dhe kanë vazhduar me mungesën gjithnjë e më të madhe të punëtorëve.
Në veprimtarinë e tyre shpesh kanë luajtur rol edhe kushtet klimatike, që i kanë zvogëluar të korrat.
Qeveria e Kosovës, nga viti 2022, ndan subvencione për bujqit, por ata, prapëseprapë, nuk arrijnë t'i plotësojnë nevojat e qytetarëve të Kosovës, sidomos për grurë.
Zejnullahu pret që, sivjet, të ketë edhe më pak prodhime të grurit dhe çmimet e këtij produkti të jenë më të larta.
Ai nuk është kundër tatimit, por thotë se "nuk është dashur të ngarkohet bujku që e punon tokën, por ai që nuk e punon".
Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se vendi ka mbi 512 mijë hektarë tokë të përshtatshme për bujqësi, por për qëllime të ndryshme shfrytëzohen mbi 420 mijë hektarë.
Sipas ASK-së, rreth 189 mijë hektarë shfrytëzohen për rritjen e kulturave bujqësore, mbi 217 mijë hektarë hyjnë në kategorinë e livadheve dhe kullotave, ndërsa sipërfaqet e tjera janë plantacione për pemë, perime dhe kopshte.
Kosova, prej vitesh, përballet me deficit të lartë tregtar, që do të thotë se importon më shumë sesa eksporton, përfshirë këtu edhe prodhime bujqësore.
Vendi nuk i plotëson as nevojat e popullatës për grurë dhe importon nga fqinjët ose vendet e Bashkimit Evropian.
Prodhimi vendor i grurit, ndër vite, është rreth 300 mijë tonë, kurse nevojiten mbi 410 mijë tonë.
Saktësisht një vit më parë, Radio Evropa e Lirë ka raportuar për reduktim të sipërfaqes së tokës së punuar në Rahovec - komunë ku, sipas të dhënave zyrtare, afro 65 për qind e popullatës e sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore.
Afrim Limani, drejtor për buxhet dhe financa në Komunën e Rahovecit, konfirmon për Radion Evropa e Lirë se tatimi në toka bujqësore ka nisur të paguhet, por "jo në masë".
Profesori i Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës, Imer Rusinovci, thotë se tatimi për tokat bujqësore është dashur të shtyhet derisa të ketë një qëndrueshmëri në këtë sektor."...sepse kjo më pas ndikon me import marramendës, pasi fermerët përballen me konkurrencë të fuqishme, nëse nuk i mbështet dikasteri përkatës", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.
Federata Sindikale e Bujqve të Kosovës konfirmon se ka nisur të pranojë tashmë disa ankesa nga bujqit."Kjo nuk është në rregull", thotë udhëheqësi i kësaj shoqate, TahirTahiri, duke shtuar se, së shpejti, do të mbahet mbledhja e kryesisë së sindikatave dhe ankesat e bujqve do të adresohen tek autoritetet përgjegjëse.
Duke e paraqitur si një lloj lehtësimi, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve thotë se tokat bujqësore në vlerë deri në 50 mijë euro, nuk do t'i nënshtrohen tatimit në pronë."Fermeri vendos vetë se cilën njësi bujqësore që arrin vlerën deri në 50 mijë euro, dëshiron ta lirojë nga tatimi. Kërkesa për lirim bëhet në komunën përkatëse, ku gjendet parcela", sqaron ministria.
Vehapi, i cili kultivon kryesisht grurë, thotë se kjo është e pamjaftueshme, pasi, siç shprehet, çdo hektar toke që e punon në komunën e tij, llogaritet mbi 50 mijë euro.
Derisa fushata e korrje-shirjeve pritet të nisë në më pak se dy muaj, Vehapi thotë se është duke u hamendur nëse, vitin e ardhshëm, do të vazhdojë ta mbjellë sipërfaqen e njëjtë të tokës, apo do ta zvogëlojë atë.

# Bizneset e quajnë të domosdoshëm digjitalizimin e kompanive dhe administratës shtetërore

PRISHTINË, 26 MAJ - Kompanitë vendore po e shohin të rëndësishëm dhe të domosdoshëm digjitalizimin e bizneseve dhe administratës shtetërore.
Është bërë thirrje që të ketë më shumë bashkëpunim ndërmjet bizneseve e qeverisë në mënyrë që të rinjtë të zhvillojnë karrierë brenda vendit e të mos largohen në shtetet perëndimore.
Drejtori i burimeve njerëzore dhe administratës në "Meridian Corporation", Abdylkerim Ratkoceri, ka thënë se digjitalizimi është shumë i rëndësishëm në kompani dhe se duhet punuar më shumë në këtë aspekt që vendi të ecë në hap me kohën. "Unë mendoj që është shumë e rëndësishme. Ne duhet të gjithë të ecim me kohën sikurse kjo është duke u aplikuar edhe në shkolla, posaçërisht në Bashkimin Evropian dhe ShBA. Mirëpo edhe në kompani duhet se është një lehtësim i procesit të rekrutimeve. Është një ndihmesë shumë e mirë, mirëpo teknologjia në përgjithësi duhet të prosperojë dhe të ecim përpara", ka thënë ai.
Ratkoceri ka thënë se prioritet i qeverisë duhet të jetë financimi i kompanive me politika të ndryshme në mënyrë që bizneset të jenë në hap me zhvillimet teknologjike, sikurse bizneset që operojnë në vendet e tjera.
Edhe Burbuqe Grajqevci, menaxhere e burimeve njerëzore në Kreditimin Rural të Kosovës, ka thënë se digjitalizimi i proceseve administrative është shumë i rëndësishëm që ta bëjë më të lehtë punën për zyrtarët dhe qytetarët.
Grajqevci thotë se çdo ndihmë që do të vinte nga institucionet shtetërore për këtë çështje është e mirëseardhur për gjithë tregun në Kosovë. "Platformat si këto na ndihmojnë që ne këto procese të mos i bëjmë nga zero vetë, për shkak se janë të kushtueshëm dhe jemi kompani më të vogla dhe nuk ia vlen që ne këtë proces ta zhvillojmë vetë nga fillimi kështu që platforma të tilla janë të mira edhe na ndihmojnë të përmirësojmë proceset e rekrutimit. Kjo do të ishte e nevojshme dhe do t'u ndihmonte kompanive më të vogla, gjithashtu nëse ka diçka që zhvillohet nga institucionet është e mirëseardhur për të gjithë tregun", ka thënë ajo. /EO



# Xhaketa ushtarake e gjeneral Ali Ahmetit, me gjak të dëshmorit të Kombit e veshur nga përfaqësuesi i NATO-s, Pieter Feith



Ismet SYLEJMANI



Tanimë dihet botërisht, se Ushtria Çlirimtare Kombëtare, është themeluar, është rritur dhe ka hedhur shtat të shëndoshë e të mbrujtur me fanatizëm origjinal luftarak çlirimtar, popullor kombëtar, nën kujdesin e vazhdueshëm të themeluesit të saj, Kryekomandantit të Përgjithshëm Gjeneral Ali Ahmetit!

Gjeneral Ali Ahmeti me zgjuarsinë dhe shkathtësinë e Tij ushtarako-politike, atdhetare e patriotike, UÇK-në e ka orientuar drejt kursit politiko-patriotik atdhetar të rilindasve dhe vlerave më të mëdha heroike të të parëve tanë, atyre që luftuan e derdhen gjak për truall e për mbrojtje nga invadorë të hapsirës shqiptare e nga padrejtesitë pushtuese, shkelës të të drejtave kombëtare e cenues të të drejtave njerëzore dhe me diplomaci të paparë e drejtoi drejt aleancës së madhe të miqësisë së përhershme me SHBA-në dhe drejt kursit të përhershëm euroatlantik!

Maqedonia e Veriut, pas ardhjes në pushtet të Gjeneral Ali Ahmetit, është shqiptarizuar deri në përmasa të tilla, aq sa për çdo ndryshim, vula e aktivitetit dhe angazhimit të Tij, duket qartë dhe do të mbetet emblema përfaqesuse e interesave përmanente dhe historiko-strategjike e të ardhmës se ndritur dhe të integruar euroantlantike, jo vetëm të shqiptarëve në këtë shtet anëtare e NATO-s!

Themeluesi e Kryekomandanti i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe luftëtari i madh për çlirimin e shqiptarëve dhe realizimin e Idealit Kombëtar, Heroi i gjallë i Kombit tonë, Udhëheqësi largpamës e i guximshëm i popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut Ali Ahmeti, është në foto me personalitetin e shquar ndërkombëtar, përfaqesuesin e NATO-s në Maqedoni të Veriut Pieter Feith!

Një foto me dy personalitete të mëdha kombëtare e ndërkombëtare!

Uniforma ushtarake e UÇK-së, e Gjeneral Ali Ahmetit e ndarë dysh!

Xhaketa ushtarake e Gjeneral Ali Ahmetit, me gjak të Dëshmorit të Kombit e veshur nga përfaqësuesi i NATO-s Pieter Feith!

Kjo është foto historike!

Foto që historia do të shkruaj përgjithmonë!

Diplomati botëror Pieter Feith me uniformën e UÇK-së, të cilën gjatë luftës çlirimtare e kishte bartuar Kryekomandanti Ali Ahmeti!

Është historike dhe e paharruar nga memoria e kombit, që Gjeneral Ali Ahmeti, simboli i grykës së pushkës dhe flakës së luftës të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, e cila shpartalloi të gjitha planet dhe projektet antishqiptare në Maqedoninë e Veriut, uniformën e Tij, të ia veshi Ambasadorit Pieter Feith, kjo është edhe një dëshmi se AA – është figura më markante kombëtare!

Drejtuesi i lartë i LPK-së, Udhëheqësi i Madh i popullit shqiptar, Gjeneral Ali Ahmeti, është shtrati dhe mendja origjinale e shtatit të strategut të artit skenderbegian dhe heroik-diplomatik e politiko-ushtarak të UÇK-së!

Gjeneral Ali Ahmeti, me UÇK-në, ka luftuar dhe ka derdhur gjak për liri, për çlirim e për bashkjetesë me dinjitet e faqe të bardhë në Maqedoninë e Veriut!

Gjeneral Ali Ahmeti me UÇK-në, që kanë luftuar dhe kanë derdhur gjak për tokë, për pushtet politik e për pushtet kombëtar me dinjitet, janë krenaria dhe nderi i kombit, popullit dhe Atdheut!

*Prishtinë, 26 Maj 2024!*

# Biopiku i mërzitshëm për heroinën e "Tangos së fundit në Paris"



Nga: **Robbie COLLIN**, kritik filmi / *The Daily Telegraph*
*Përkthimi: Telegrafi.com*

Kur Bernardo Bertolucci shpjegoi se pse ai dhe Marlon Brando kishin krijuar skenën e pashkruar të përdhunimit të aktores 19-vjeçare Maria Schneider – gjatë xhirimeve të filmit Tango e fundit në Paris [Last Tango në Paris] – regjisori italian tha se kërkonte "një reagim sa më real".

Dramatizimi i Jessica Paludit për jetën e trazuar të Schneiderit – i cili u shfaq në Kanë – është film i realizuar si përgjigje ndaj këtij reagimi: lotët e poshtërimit dhe tronditjes që u morën përmes mashtrimit që e bënë filmin e Bertoluccit sensacion, e shkatërruan jetën e yllit të ri shpresëdhënës drejt tmerrit të cilin ajo nuk e donte.

Shprehja e shkaqeve dhe arsyeve të këtij akti përdhunues – të shkaktuar nga burrat e fuqishëm ndaj një gruaje të re të panjohur, për hir të artit të tyre – është arsyeja për ta bërë filmin Të jesh Maria [Being Maria]. Dhe, kjo pjesë për të cilën u bë filmi, është gjithashtu arsyeja për ta parë. Përshtatur nga kujtimet Kushërira ime Maria Schneider [My Cousin Maria Schneider] nga gazetarja Vanessa Schneider, filmi i Paludit është njëkohësisht i kënaqshëm dhe zhgënjyes: një hapje e tendosur, moralisht irrituese që ndiqet nga një rrëfim shumë më i këndshëm dhe më i thjeshtë i pasojave, nuk mund të mos e bëjë të mos duket si një orë e tërë me sqarime shtesë.

"U ndjeva paksa e përdhunuar", kështu i përshkroi vetë Schneider xhirimet e skenës, dhe ndërkohë që skenari i Paludit dhe Laurette Polmanssit shtron në mënyrë metodike kushtet në të cilat veprimet e Bertoluccit dhe Brandos mund të ishin dukur të arsyeshme për vetë ata në xhirime, kjo të lë në dyshimin nëse – edhe pse vetë përdhunimi u bë – dhuna e kryer ishte reale.

Aktruar nga aktorja franko-rumune Anamaria Vartolomei, Maria fillon si një figurë e matur, por edhe optimiste: nuk mund ta besojë fatin e saj për të punuar me një legjendë të Hollivudit, 29 vjet më i vjetër se ajo, në rolin e saj të parë madhor. Babai i saj (Yvan Attal), aktori francez i angazhuar me raste, Daniel Gélin, ripohon se çfarë privilegji paraqet ky rol – ndërsa në xhirime, Bertolucci (Guiseppe Maggio) krenohet se filmat e tij nuk përmbajnë aktorë, por njerëz, ndërsa Brando (Matt Dillon, i cili nga këndvështrimet e caktuara i ngjan dikujt tjetër) duke pëshpëritur shpreh fuqinë e "emocionit të vërtetë" në ekran. Alarmi paralajmërues bie kur, gjatë një skene fillimisht të butë të larjes, Brando papritur e shtyn Marian nën ujë dhe e mban aty. Më pas, teksa rri ulur në banjë ende e zhveshur, ai dhe Bertolucci e diskutojnë me zë të lartë këtë moment mbi kokën e saj, sikur ajo të mos ishte asgjë tjetër veçse një rekuizitë. Por, këta janë gjenialët në punë dhe askush – më së paku vajza që kanë denjuar ta çojnë në nivelin e tyre – nuk duhet të kundërshtojë. Si të tillë, kur vjen koha për skenën fatale, marrin pikërisht atë që duan: regjistrimin vizual të vdekjes së pafajësisë së një gruaje të re. Por, është Maria, jo personazhi i saj ajo që ka mbetur për të vuajtur.

Pasojat afatgjata janë dëshpëruese, por edhe të rëna në tensionin dramatik dhe jetësor. Brando dhe Bertolucci largohen, duke e lënë atë që të përballojë si e vetme skandalet e Tangos së fundit, ndërsa skenarët që ia dërgojnë janë seksuale deri në monotoni, pasi regjisorët e tjerë kërkojnë të fitojnë para. Ngushëllimin e gjen te droga, gjë që e bën atë të papërshtatshme në xhirime. Romanca me një studente më të re të filmit (Céleste Brunnquell) ia sjell njëfarë ngushëllimi, por gjithashtu ndihet si sajesë për t'i dhënë një formë ngjarjes. Ndoshta kjo e metë është tipari i zymtë i integruar i temës së të qenit Maria: vetë Schneiderit iu mohua akti i saj i dytë. */Telegrafi/*




# Sport



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Shpëtim Duro emërohet trajner i Suharekës



Suharekë, 26 maj - FC Suhareka është bërë me trajner të ri. Përmes një postimi në faqen e klubit, ekipi nga Suhareka njoftoi se ka caktuar Shpëtim Duron si trajner të skuadrës. Arsim Thaqi udhëhoqi klubin në inkuadrimin në Superligë dhe tani në elitë FC Suhareka do të drejtohet nga trajneri nga Shqipëria, Shpëtim Duro. "Kemi arritur marrëveshje bashkëpunimi për të marrë drejtimin e skuadrës me kryetrajnerin Shpëtim Duro. Timonieri nga Shqipëria do drejtoj skuadrën tonë drejt synimeve të radhës tashmë pjesë e elitës së futbollit Kosovar, Duro trajner me shumë eksperiencë ku së fundmi ishte pjesë e FC Struga nga Maqedonia ku vitin e kaluar arriti të shpallej kampion dhe të ishte pjesë e garave evropiane, në të kaluarën ka udhëhequr me sukses skuadra si KF Partizani, KF Shkëndija, FC Drita, FC Kukësi e KF Laçi. Kryesia e klubit ishin të pajtimit që ti besojnë trajnerit Duro për udhëheqjen e skuadrën ku u betuan që do qëndrojnë afër me kushtet dhe gjitha mundësitë që klubi ynë të shkëlqejë në superligë, në anën tjetër trajneri theksoi se së bashku të bashkuar do punojmë maksimalisht dhe me plan projekt profesional", thuhet në njoftimin e Suharekës.

# KHF Istogu, kampion i Kosovës në hendboll

Istog, 26 maj - Istogu është kampion i Kosovës në hendboll për edicionin 2023/2024. Në finale të plejofit, Istogu e mposhti Ferizajn. Pas fitores së arritur të enjten në Ferizaj, Istogu fitoi edhe të dielën mbrëma në Banjë, me rezultat 31:30. Kështu me rezultat 2:0 në serinë finale, Istogu e mbrojti titullin e kampionit të Kosovës. Për skuadrën istogase është titulli i katërt në histori dhe i treti rresht. Fillimisht Istogu kishte triumfuar në edicionin 2018/19 e më pas edhe në edicionet 2021/2022 dhe 2022/2023. Ndeshja e së dielës ishte shumë e fortë dhe shumë interesante. Pas pjesës së parë Ferizaj ishte në epërsi prej një goli, 15:14. Por në pjesën e dytë skuadra vendase shfaqi më shumë dhe ishte gjithë kohën në epërsi. Por lufta sportive nuk është ndalur deri në fund. Istogu ia doli të mbajë epërsinë për festë të madhe në fund të takimit. Kupën e kampionit, kapitenes së Istogut, Albina Rugova, ia dorëzoi presidenti i FHK-së, Eugen Saraçini. Për Rugovën ishte ndeshja e fundit me



Istogun. Ajo karrierën e vazhdon në Zvicër. Largohet si kampione dhe si ikonë e hendbollist istogas. Ana Carolina Gomes ishte më efikasja tek Istogu me dhjetë gola. Tetë i kishte Esma Muratoviq, katër Arlinda Dinarica e nga tri Albina Rugova e Tainara Luna Goncalves. Shumë pritje kishte Aleksandra Bazoviq. Te Ferizaj, Salematou Camara i kishte shtatë gola. Pesë i shënoi Anja Bojaniq e nga katër Luljeta Sopjani, Amanda Stein e Simone Keita. Nuk ndihmuan as pritjet e Teninke Kabas. Istogu e Ferizaj kanë zhvilluar garë të fortë e interesante këtë edicion. Dhe gara u mbyll me një ndeshje shumë të fortë e shumë interesante.

# Prishtina e Re përballet me Feronikelin 74 në barazhin për hyrje në Superligë

Drenas, 26 maj - Prishtina e Re e ka siguruar biletën për ndeshjen e barazhit kundër Feronikelit 74, e cila do të zhvillohet më 1 qershor në Klinë. Kjo ndeshje vendimtare do të përcaktojë se cila nga këto dy skuadra do të luajë në edicionin e ardhshëm në AlbiMall Superligë. Në një ndeshje dramatike të barazhit të Ligës së Parë, e cila u zhvillua në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas, Prishtina e Re triumfoi ndaj Dinamos së Ferizajt, pas një serie të gjatë penalltish. Rezultati përfundimtar i penalltive ishte 7:6 në favor të Prishtinës së Re, pas një ndeshje



që përfundoi 2:2 në kohën e rregullt dhe 3:3 pas vazhdimeve. Portieri Egzon Bislimi ishte heroi i vërtetë i Prishtinës së Re në këtë ndeshje, duke pritur disa penallti të lojtarëve të Dinamos. Performanca e tij e shkëlqyer e udhëhoqi skuadrën drejt kësaj fitoreje të rëndësishme. Në minutën e 22-të, Fidan Gërbeshi shënoi për Dinamon nga penalltia, por Salih Kosumi i barazoi shifrat shtatë minuta më vonë. Dinamo kaloi sërish në epërsi me golin e Daniel Tettes në minutën e tretë të shtesës së pjesës së parë. Megjithatë, Prishtina e Re barazoi shpejt pas fillimit të pjesës së dytë me një gol të Vigan Ademit (47'). Në vazhdimet prej dy herë nga 15 minuta, prishtinasit kaluan në epërsi me golin e Urim Statovcit në minutën e 104-t, por Dinamo barazoi shpejt me golin e Dardan Jasharit vetëm dy minuta më vonë.

Me këtë fitore, Prishtina e Re është vetëm një hap larg hyrjes në Superligën e Kosovës dhe do të përballet me Feronikelin 74 në një ndeshje që pritet të jetë shumë interesante dhe emocionuese, e ku të dy skuadrat do të japin maksimumin për të siguruar vendin e tyre në elitën e futbollit kosovar për sezonin e ardhshëm.

## Egnatia fiton titullin e parë kampion të Shqipërisë

Tiranë, 26 maj - Kategoria Superiore uli siparin e sezonit 2023/2024 mbrëmjen e sotme me finalen e "Final 4", mes Partizanit dhe Egnatias, që u fitua nga rrogozhinasit me rezultatin 0-1, duke u kurorëzuar për herë të parë në histori si kampione e elitës së futbollit shqiptar. Skuadra e trajnerit Idlir Tetova arriti t'i rrëmbente kështu "kurorën" të kuqve të Orges Shehit, që ishin edhe kampionët në fuqi të sezonit të shkuar. Vlen të theksohet fakti se Partizani humbi shansit e artë për të barazuar Dinamon për sa i përket titujve të fituar. "Bardheblutë" e Tiranës kanë rekordin absolut sa u përket titujve të fituar me 26 trofe. Ndërkohë që në vendin e dytë, ndodhet Dinamo me 18 tituj më pas vjen Partizani me 17. Dominimin e klubeve kryeqytetase ndër dekada janë munduar ta thyejnë Vllaznia, që ka fituar 9 tituj kampion, dhe Skënderbeu me 8 tituj. Nga dy herë janë shpallur kampion Teuta dhe Elbasani dhe nga një herë Kukësi dhe Flamurtari.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 11A të Rregullores (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme me Nr. 614 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

## KONKURS
## për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. **Pozita:** **Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa**
   **Numri i referencës:** DDBF/ZKA/05-08/24
   **Grada:** ZKA-C2
   **Numri i pozitave:** Një (1)
   **Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

**Detyra 1:** Caktimi i objektivave të departamentit në përputhje me strategjinë dhe objektivat e ZKA-së dhe dizajnimi i planeve vjetore të punës të detajuara për t'i përmbushur këto objektiva;
**Detyra 2:** Planifikimi dhe përgatitja e propozim-buxhetit të ZKA-së;
**Detyra 3:** Ekzekutimi i pagesave dhe transaksioneve të tjera financiare;
**Detyra 4:** Menaxhimi dhe ofrimi i shërbimeve me qëllim të ofrimit të mbështetjes për të gjithë personelin e ZKA-së;
**Detyra 5:** Analizimi dhe vlerësimi i proceseve dhe procedurave të brendshme dhe dhënia e rekomandimeve për ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
**Detyra 6:** Përgatitja/hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore, raportimi periodik te Drejtori i Përgjithshëm dhe Auditori i Përgjithshëm si dhe përgatitë të dhëna për raportin vjetor të performancës;
**Detyra 7:** Siguron dhe ofron informata për Drejtorin e Përgjithshëm dhe e këshillon atë rreth menaxhimit financiar, procedurave, kontrolleve financiare, me qëllim se të gjitha proceset administrative dhe teknike të ZKA-së janë duke operuar në mënyrë efikase dhe efektive.
**Detyra 8**: Merr pjesë në hartimin e Raportit vjetor të performancës të ZKA-së për të dhënat nga fushat përkatëse;
**Detyra 9**: Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Drejtori i përgjithshëm.

**Kualifikimet themelore:**
- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale.

**Shkathtësitë e kërkuara**:
- Shkathtësi të avansuara në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

**Informata të përgjithshme për kandidatë:**
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Procedura e Aplikimit:**
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**
- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **11.06.2024 ora 16:00.**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U području člana 15.2. Zakona br. 05/L-055 o generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i člana 5., 6. i 7. Uredbe (NKR) 01/2024. o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije, u vezi sa članom 11A Uredbe (NKR) br. 02/2021. o klasifikaciji radnih mesta (izmenjena i dopunjena Uredbom (NKR) br. 01/2023.; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2024. godinu kao i Odluke Glavnog revizora sa br. 614 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije raspisuje:

## KONKURS
## za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. **Pozicija:** **Direktor Departmana za budžet i finansije**
   **Broj reference:** DDBF/NKR/05-08/24
   **Stepen:** NKR-C2
   **Broj pozicija:** Jedna (1)
   **Trajanje imenovanja:** Na neodređeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti:**

**Zadatak 1:** Određivanje ciljeva departmana u skladu sa strategijom i ciljevima NKR-a i dizajniranje godišnjih planova rada detaljiziranih za postizanje ovih ciljeva;
**Zadatak 2:** Planiranje i priprema predloga-budžeta NKR-a;
**Zadatak 3:** Izvršenje plaćanja i drugih finansijskih transakcija;
**Zadatak 4:** Upravljanje i pružanje usluga u cilju pružanja podrške za svo osoblje NKR-a;
**Zadatak 5:** Analiziranje i procena unutrašnjih procesa i procedura i davanje preporuka za izmene/poboljšanja u cilju povećanja efikasnosti rada;
**Zadatak 6:** Priprema/izrada Godišnjih finansijskih izveštaja, periodično izveštavanje Generalnog direktora i Generalnog revizora, kao i priprema podataka za godišnji izveštaj o učinku;
**Zadatak 7:** Obezbeđuje i pruža informacije Generalnom direktoru i savetuje ga o finansijskom upravljanju, procedurama, finansijskim kontrolama, sa ciljem da svi administrativni i tehnički procesi NKR-a rade na efikasan i efektivan način.
**Zadatak 8**: Učestvuje u izradi Godišnjeg izveštaja o učinku NKR-a za podatke iz odgovarajućih oblasti;
**Zadatak 9**: Obavlja druge zadatke utvrđene od Generalnog direktora.

**Osnovne kvalifikacije:**
- Fakultetska diploma;
- Sedam (7) godina stručnog radnog iskustva koje se nadovezuje sa radnim mestom;
- Tri (3) godine menadžerskog iskustva.

**Zahtevane veštine**:
- Napredne veštine u upravljanju, organizaciji i određivanju ciljeva;
- Odlično poznavanje efektivnog nadzora stručnog rada;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Sposobnost rukovođenja, motivacije i komunikacije u upravljanju učinkom;
- Posedovati dobre interpersonalne sposobnosti.

**Opšte informacije za kandidate:**
Utvrđivanje plate vrši se u skladu sa zakonodavstvom na snazi.

**Procedura apliciranja:**
Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

**Kandidati moraju dostaviti potrebne dokumente, kao dole:**
- Službeni obrazac NKR-a za apliciranje;
- Kopija lične karte Republike Kosova;
- Dokaz o obrazovnoj pripremi (fakultetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- Dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu propraćena dokazom iz Trusta);
- Dokaz iz suda da nije osuđivan pravosnažnom odlukom (ne stariji od šest meseci);
- Dokaz da nema na snazi disciplinsku meru za razrešenje sa pozicije javnog službenika (*ako se primenjuje*);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzeti u obzir. Dokumenti dostavljeni nakon predviđenog roka neće se razmatrati, a oni nepotpuni biće odbijeni. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume biće kontaktirani. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*online*) i na internet stranici Nacionalne kancelarije revizije. Poslednji rok za dostavljanje dokumentacije je datum **11.06.2024. u 16:00 časova.**

Obrasci za apliciranje mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa internet stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Diviziji za administriranje dokumenata na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 - Priština, svakog radnog dana od 08:00 - 16:00 časova, obrazac i prateći dokumenti se takođe mogu dostaviti i putem elektronske adrese na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete kontaktirati na br. tel. 038/606-004, ext:1025.

**Beleška:**
Aplikacije dostavljene poštom, koje sadrže poštanski žig o dostavi izvršenoj poslednjeg dana roka za apliciranje, će se smatrati valjanim i biće uzete na razmatranje.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 14 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme me Nr. 614 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

## KONKURS
## për plotësimin e vendit të lirë të punës

| | |
|---|---|
| **1. Pozita:** | **Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit** |
| **Numri i referencës:** | UNP/ZKA/05-07/24 |
| **Grada:** | ZKA-C3 |
| **Numri i pozitave:** | Një (1) |
| **Kohëzgjatja e emërimit:** | Me kohë të pacaktuar |

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Hartimi i Planit vjetor të punës për vitin përkatës për Njësinë e Prokurimit;
- Hartimi i propozim planit vjetor të prokurimit dhe koordinimi i aktiviteteve më njësitë kërkuese për hartimin e planit;
- Menaxhimi i të gjitha aktiviteteve të prokurimit në përputhje me Planin vjetor të prokurimit publik dhe legjislacionin në fuqi;
- Hulumtimi i tregut me qëllim të realizimit të aktiviteteve të prokurimit në mënyrën më efikase dhe ekonomike;
- Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura dhe nxjerr urdhër-blerjet me kohë dhe sipas kushteve të kontratës;
- Përcakton metodologjinë e prokurimit për tender dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve dhe ofron këshilla dhe asiston menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave;
- Menaxhon me dosjet e prokurimit, duke përfshirë sistemimin, klasifikimin dhe arkivimin e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore dhe raporton rregullisht për punët e kryera dhe realizimin e detyrave;
- Bashkëpunimi me organet tjera kompetente për prokurimin publik – AQP dhe KRPP;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm.

**Kualifikimet themelore:**

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Të jetë i certifikuar për prokurim publik sipas legjislacionit në fuqi.

**Shkathtësitë e kërkuara**:

- Shkathtësi të avansuara në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

**Informata të përgjithshme për kandidatë:**
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Procedura e Aplikimit:**
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Certifikatë sipas legjislacionit përkatës për prokurimin publik;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **11.06.2024 ora 16:00.**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije vezano sa Članom 14 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu za regrutaciju za 2024. godine, kao i Odlukom Generalne revizorke br.614, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

## KONKURS
## za popunjavanje slobodnog radnog mesta

| | |
|---|---|
| **1. Pozicija:** | **Rukovodioc Jedinice za nabavku** |
| **Referentni broj:** | UNP/ZKA/05-07/24 |
| **Rang:** | ZKA-C3 |
| **Broj pozicija:** | Jedna (1) |
| **Trajanje imenovanja:** | Na neodređeno vreme |

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Izrada godišnjeg plana rada za relevantnu godinu za Jedinicu nabavke;
- Izrada predloga godišnjeg plana nabavki i koordinacija aktivnosti sa zahtevnim jedinicama za izradu plana;
- Upravljanje svim aktivnostima nabavke u skladu sa godišnjim planom javnih nabavki i zakonima na snazi;
- Istraživanje tržišta u cilju obavljanja aktivnosti nabavke na najefikasniji i najekonomičniji način;
- Nadzor realizacije zaključenih ugovora i izdaje naloge za kupovinu na vreme i prema uslovima ugovora;
- Određuje metodologiju tenderske nabavke i procedure procene cena i daje savete i pomaže menadžmentu u donošenju odluka u vezi sa spornim pitanjima koja se mogu pojaviti u slučajevima izvršenja ugovora;
- Upravlja dosijeima nabavke, uključujući sistematizaciju, klasifikaciju i arhiviranje dokumentacije u skladu sa zakonskim zahtevima i redovno izveštava o obavljenom poslu i ispunjavanju zadataka;
- Saradnja sa drugim nadležnim organima za javne nabavke – CAN i RKJN;
- Obavlja i druge poslove koje odredi Generalni direktor.

**Osnovne kvalifikacije:**

- Fakultetska diploma;
- Sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva koja se povezuje sa radnim mestom;
- Tri (3) godine rukovodećeg iskustva;
- Da bude sertifikovan za javne nabavke u skladu sa važećom zakonskom regulativom.

**Potrebne veštine**:

- Napredne veštine u upravljanju, organizaciji i postavljanju ciljeva;
- Odlično poznavanje efektivnog nadzora nad stručnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Liderske, motivacione i komunikacione veštine u upravljanju učinkom;
- Da poseduje dobre međuljudske veštine.

**Opšte informacije za kandidate:**
Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

**Procedura apliciranja:**
Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

**Kandidati trebaju predati sledeća potrebna dokumenta:**

- službeni formular NKR-a za aplikaciju;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- Sertifikat prema odredenom zakonodavstvu za javne nabavke;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Penzionog fonda);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog funkcionera (*ako je primenljiva*);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenta dostavljena nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpuna će biti odbijena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (*onlajn*) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **11.06.2024.** godine do **16.00 časova.**

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Beleška:**
Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 2317/23 të datës 03.05.2023, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Telefon: + 381 38 200 32 222










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Ylyrian Travel Agency" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812145599.

- Gëzim M. Berisha B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810948234.

- Ilmi Sadrija shpall të humbur Certifikatën Furrtari, Mbi Aftësimin Profesional të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës me nr. 653/2015.

- Serdar Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - lX shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Albrim Isakaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat , certifikatën dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Armand Xhemaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K"11 Marsi" Prizren.

- Fatlind Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Driton Ahmetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.l.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Ardian Kryeziu nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Asllan Berisha" Rogovë KK Gjakovë.

Florent Gashi nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Asllan Berisha" Rogovë KK Gjakovë.

Saranda Koci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Zekiria Rexha" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.


MEKA®
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA®
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES
95 g


100% Fresh & Natural
VIDAS
Llatte drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME FINESË DHE DASHURI
2,8%
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
100% i Freskët Natyral
JOGURT
VIDAS
DHALLË


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L